



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:168434
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05718561

PPP.nr.74/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Armend Ahmeti, në çështjen përbarimore të kreditorit K.K.F.E.E. Sh.a (KESco), me seli në Prishtinë, Bulevardi K.K.F.E.E., Nr. ..., Ndërtesa E..., Kati ..., Prishtinë, me NUI ..., kundër debitorit Shtalla e Lopëve A.H.B., Adresa K.-1, Ferizaj, me bazë juridike përbarimore, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit kundër urdhrorit të përbaruesit privat M.Sh. në Ferizaj P.nr.339/20, të datës 05.11.2020, jashtë seancës më dt. 22.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR prapësimi i debitorit Shtalla e Lopëve A.H.B., i ushtruar kundër urdhrorit për përbarim të përbaruesit privat M.Sh. në Ferizaj P.nr.339/20, të datës 05.11.2020, për shumën e borxhit të kërkuar prej 662,89€ (gjashtëqind e gjashtë dhjetë e dy euro e tetëdhjetë e nëntë cent) dhe **SHFUQIZOHET** dhe **lihet jashtë fuqisë juridike** urdhëri P.nr.339/20, të datës 05.11.2020, sa i përket shumës së borxhit prej 662,89€, për shkak të parashkrimit.

II. REFUZOHET PJESËRISHT SI I PABAZUAR prapësimi i debitorit Shtalla e Lopëve A.H.B., i ushtruar kundër urdhrorit të përbaruesit privat M.Sh. në Ferizaj P.nr.339/20, të datës 05.11.2020, sa i përket shumës së borxhit prej 138.19€ (njëqind e tridhjetë e tetë euro e nëntëmbëdhjetë cent) dhe shpenzimet e procedurës përbarimore në shumë prej 40.12€ (katërdhjetë euro e dymbëdhjetë cent) dhe **MBETET në fuqi** urdhëri për lejimin e përbarimit

P.nr.339/20, të datës 05.11.2020, për shumën e borxhit prej 138.19€ dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore në shumë prej 40.12€.

A r s y e t i m

Kreditore K.K.F.E.E. sh.a me seli në Prishtinë (më tej: KESco), ka paraqitur propozim për përmbaremore në bazë të dokumentit të besueshëm- ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të energjisë elektrike, kundër debitorit Shtalla e Lopëve A.H.B., Adresa K.-..., Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të lejohet përmbaremore për pagesën e borxhit në shumë prej 801,08€, për konsumin e energjisë elektrike nga data 13.04.2016 deri më dt. 29.09.2020, në emër të borxhit kryesor, me kamatë prej 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë deri në pagesën definitive të borxhit, në llogarinë bankare të kreditorit, si dhe shpenzimet e këtij ekzekutimi.

Përmbaremore privat M.S.Sh. në Ferizaj, me urdhërin P.nr.339/2020, të dt. 05.11.2020, e ka lejuar përmbaremoren e propozuar.

Kundër urdhërit të përmbaremoret privat, në afatin e përcaktuar ligjor, ka ushtruar prapësim debitori, duke u thirrur në parashkrimin e borxhit me propozim që të aprovohet në tërësi i themeltë prapësimi i debitorit dhe shfuqizohet urdhëri për përmbaremore P.nr.339/2020, të dt. 05.11.2020 i përmbaremoret privat M.S.Sh. në Ferizaj.

Kreditore në afatin ligjor ka ushtruar përgjigje në prapësim duke i propozuar gjykatës që ta pranoj prapësimin si të bazuar dhe ta anuloj urdhërin për përmbaremore.

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit, ka nxjerrë aktvendim PPP.nr.383/20, të dt. 08.07.2021, me të cilin pranohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit i ushtruar kundër urdhërit për lejimin e përmbaremoret P.nr.339/2020, të dt. 05.11.2020 i përmbaremoret privat M.S.Sh. në Ferizaj dhe shfuqizohet pjesërisht urdhri për lejimin e përmbaremoret P.nr.339/2020, të dt. 05.11.2020, vetëm sa i përket borxhit për periudhën prej datës 21.03.2016 deri më 14.08.2017 për shkak të parashkrimit të kërkesës, ndërsa lihet në fuqi pjesa tjetër e urdhërit që ka të bëjë me borxhin e mbetur në shumë prej 25.80€, për periudhën prej 15.08.2017 deri më 29.10.2020 dhe detyrohet debitori që kreditorit tia paguaj shpenzimet e përmbaremoret privat në shumë prej 40,12€.

Kundër këtij aktvendimi, kreditori kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, kurse Gjykata e Apelit me Akvendimin Ac.nr.6726/2021 të datës 30.05.2023 e ka aprovuar ankesën si të themeltë ankesën e kreditorit KEDS-KESCO sh.a me seli në Prishtinë, anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj PPP.nr.383/20, të dt. 08.07.2021 dhe çështja i kthehet të njëjtës gjykatë në procedim të sërishëm.

Gjyqtari individual i shkallës së parë, në procedurën e rivendosjes, pasi ka shqyrtuar dhe vlerësuar prapësimin e palës debitore, si dhe shkresat e tjera të lëndës, duke marrë parasysh edhe udhëzimet e Gjykatës së Apelit, ka gjetur se prapësimi është **pjesërisht i bazuar**.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, si dokumente të besueshme listohen “ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave” ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Neni 37 i LPP parasheh se: “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, poashtu neni 38.1 i LPP parasheh se: “Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.”

Gjykata, nga të lartcekurat, gjeti se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – Ekstrakti verifikuar nga librat afarist të kontabilitetit me nr unik të konsumatorit DFE 9046746, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë ekstrakt janë treguar palët, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit. Tutje Gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri përmbarimor, i plotëson kushtet edhe në kuptim të nenit 37 të LPP-së, pasi që i njëjti i është bashkëngjitur propozimit për përmbarim në origjinal. Në propozimin për përmbarim

në bazë të dokumentit të besueshëm ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të energjisë elektrike, të ushtruar nga kreditori kundër debitorit, është kërkuar që të lejohet përmbarimi për pagesën e borxhit në shumën prej 801,08€, për konsumin e energjisë elektrike nga data 13.04.2016 deri më dt. 29.09.2020. Gjykata pas vlerësimit të ekstraktit nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të energjisë elektrike gjen se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar, duke u bazuar në nenin 355 (Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale) të LMD, në të cilin parashihet se: “1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. 2. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.” kurse në këtë përfundim erdhi bazuar në leximin e faturës me kodin tarifor 7/02 që tregon se debitori ka qenë i evidentuar si person juridik për këtë arsye vlen neni i cituar më lart. Poashtu sipas nenit 368 të LMD (Pranimi i borxhit) parashihet se: “1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit.”

Gjykata nga shkresat e lëndës gjen se propozimi për përmbarim i kreditorit është paraqitur te përmbaruesi privat me dt. 05.11.2020, ndërsa borxhi i kërkuar është për periudhën prej 13.04.2016 deri me dt. 29.09.2020. Ndërsa debitori me dt. 14.08.2020 e ka paguar shumën prej 100€ ndaj kreditorit gjë që vërtetohet me leximin e ekstraktit nga librat afariste. Me këtë pagesë debitori e ka ndërprerë parashkrimin e kërkesës së kreditorit për tri vite që i bie se nga periudha 14.08.2020 kur është bërë kjo pagesë e deri në periudhën paraprake tri vjeçare dt. 31.08.2017 është ndërprerë parashkrimi. Neni 373, par. 1, 2 dhe 6 i LMD poashtu parasheh se: “1. Pas ndërprerjes parashkrimi fillon të rrjedhë përsëri, kurse koha që ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet në afatin e caktuar ligjor për parashkrim. 2. Parashkrimi i ndërprerë me anë të pranimit (pohimit) nga ana e debitorit fillon të rrjedhë përsëri nga pranimi (pohimi). 6. Parashkrimi që fillon të rrjedhë përsëri pas ndërprerjes, mbaron kur të ketë kaluar aq kohë sa është caktuar me ligj për parashkrimin që është ndërprerë.”

Andaj gjykata ka marrë vendim që të shfuqizohet dhe lihet jashtë fuqisë juridike urdhëri për përmbarim, sa i përket shumës së borxhit prej 662,89€, për shkak të parashkrimit.

Ndërsa gjykata ka marrë vendim që të mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit, për shumën e borxhit prej 138.19€ dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në shumë prej 40.12€, për periudhën kohore nga data 29.09.2020 deri me dt. 31.08.2017.

Gjykata ka mbërritur në këtë përfundim duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 355 të LMD me arsyetimin se parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo shërbim të kryer-marrë.

Andaj duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat e në bazë të nenit 3.4 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

PPP.nr.74/23, datë 22.05.2024

Gjyqtari,

Armend Ahmeti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.